

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat të shprehura në Lek, përveçse kur parashikohet ndryshe)

### 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Communication Progress Sh.p.k ("Shoqëria") është themeluar dhe ushtron aktivitetin e saj në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Communication Progress Sh.p.k është themeluar me vendim nr. 20351 të Gjykatës së Rrethit Tiranë më datë 25 nëntor 1998, është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) me NIPT K01625001C dhe administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Shoqëria është e përfshirë në veprimtaritë e mëposhtme:

- a) Shërbime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK):
  - Konsulencë dhe menaxhim të projekteve,
  - Dizënjim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve,
  - Shërbime auditimi të sistemeve
  - Shërbime hostimi të infrastrukturave TIK dhe aplikacioneve software
  - Shërbime hostimi të bazës së të dhënave
  - Shërbime të përpunimit të të dhënave
  - Ofrimin e kurseve të formimit profesional për sistemet dhe aplikacionet e biznesit
- b) Projektim, zhvillim, implementim, testim dhe mirëmbajtje të platformave software:
  - për administrim të proceseve
  - në fushën e edukimit dhe të zgjidhjeve interaktive multimediale,
  - në fushat e punimeve topogjeodezike, gjeodezi inxhinierike, hartografi, fotogrametri, sistemet e informacioneve gjeografike (GIS), pasuritë e paluajtshme, etj.Ofrim i kurseve të formimit profesional për platformat software për nivele të ndryshme (analist, përdorues, zhvillues, trajnues, etj.)
- c) Dizënjimi grafik, zhvillimi dhe mirëmbajtje e faqeve web.
- d) Import-eksport, dizënjim, prodhim, assemblim dhe aktivitet i tregtimit me shumicë e pakicë i pajisjeve të telekomunikacionit, informatikës, elektronikës, rrjetave kompjuterike, pajisjeve të fuqisë, pajisjeve të sistemeve të sigurisë dhe akses kontrollit, kamerave, sistemeve video dhe audio, pajisjeve të transmetimit pa valë, kablllove të bakrit dhe kablllove optike.
- e) Operator i shërbimeve të telekomunikacionit për përdoruesit biznes dhe familjare:
  - Rrjete publike (aksesi apo transmetimi) të komunikimeve elektronike tokësore fikse (me përcjellësa metalikë, me fibër optike) ose me radio (wireless)
  - Shërbime publike të komunikimeve elektronike (shërbimi i aksesit në Internet, transmetimit të të dhënave)

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Gentian Likaj.

Selia kryesore e saj është në adresën: Rruga "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.19. Njësia administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 49 (dyzet e nente).

### 2. BAZAT E PËRGATITJES

#### 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK).

#### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

Shoqëria ka aplikuar SKK të përmirësuara për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 të cilat janë efektive nga 1 janari 2015 me zbatim në mënyrë prospektive. Si rrjedhojë, pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të përshtatura si më poshtë.

- 9 -

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

*(Shumat të shprehura në Lek, përveçse kur parashikohet ndryshe)*

**2.3 Monedha funksionale dhe prezantuese**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi bërjen e gjykimeve, vlerësimeve dhe supozimeve të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

*(i) Parimi i vijimësisë*

Shoqëria rezulton me një fitim prej **58.444.230 lekë** për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019. Drejtimi i shoqërisë vlerëson se shoqëria do të vazhdoje të rezultojë me fitim dhe për këtë arsye llogaritë janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

*(ii) Tatimi mbi fitimin*

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri dhe si rrjedhojë i nënshtrohet ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar.

**3. POLITIKAT KONTABËL**

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës së raportimit. Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e monedhave të huaja që vijnë nga konvertimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**3.2 Instrumente financiarë**

Instrumentet financiarë jo derivateve përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, parapagimet, llogaritë e pagueshme, dhe detyrime të tjera.

Shoqëria i një fillimisht këto instrumenta financiarë në datën e lindjes së tyre. Shoqëria regjistron një instrument financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktiviteti financiar skadojnë, ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset e parasë kontraktuale të aktivitetit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitetit financiar transferohen. Çdo interes në aktivitetet financiare të transferuar që është krijuar apo mbajtur nga Shoqëria është njohur si një aktivitet ose detyrim i veçantë.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të kompensuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përfitojë aktivitetin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare dhe nga gjendja monetare në arke .

- 10 -

## 2. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

### 3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### 3.3 Zhvlerësimi

#### *Aktivët financiarë*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive të zhvlerësimit si rrjedhojë e një ose disa ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ka një ndikim në flukset e parashikuara monetare të ardhshme të aktivitetit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë duke të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Në veçanti aktive financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor.

Humbja nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për asetet financiare të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.4 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv aktual, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.5 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura nga interesi mbi llogarinë rrjedhëse dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kursi i këmbimit.

### 3.6 Shpenzimi i Tatimit mbi fitimin

#### *(i) Viti aktual*

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveçse në rastin kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

- 11 -

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat të shprehura në Lek, përveçse kur parashikohet ndryshe)

(ii) Viti krahasues

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritsëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

**4. AKTIVET MONETARE**

Gjendja e aktiveve monetare paraqitet si me poshte:

	31/12/2019	31/12/2018
Gjendje ne arke (Kesh ne dore)	17,379	275.346
Gjendje ne Banka (Kesh ne Banka.)	72,143,226	19.693.428
Depozita afatshkurtra	2,406,641	1.094.500
<b>Total</b>	<b>74.567.246</b>	<b>21.063.274</b>

Kesh dhe ekuivalente te tij, perfshire ne shenimin e mesiperm, te analizuara ne monedhat qe vijojne:

	31/12/2019	31/12/2018
<b>Monedha lokale (LEK)</b>	58,830,648	12.439.652
<b>EURO</b>	2,988,920	8.259.286
<b>US DOLLAR</b>	12,747,678	364.336
<b>Total</b>	<b>74.567.246</b>	<b>21.063.274</b>

Shoqeria operon ne shtate banka, mjetet monetare ne valute te huaj jane vleresuar me kusin fiks te Bankes se Shqiperise te dates 31 dhjetor te vitit perkates dhe diferencat e kembimit kane kaluar ne rezultat.

**5. TË DREJTA TË ARKËTUESHME NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT**

	31/12/2019	31/12/2018
Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit	114,823,985	130.770.098
<b>TOTALI</b>	<b>114,823,985</b>	<b>130.770.098</b>

Kjo vlerë përfaqeson shumën e paarkëtuar të klienteve për shitjet nga aktiviteti.

**6. TË DREJTA TË TJERA TË ARKËTUESHME**

Të drejta të tjera të arkëtueshme përbëhen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Mbipagese tatim fitimi	3,523,531	3.589.153
TVSH per t'u rregulluar	585.022	585.022
Tatime te shtyra	45,606	
<b>TOTALI</b>	<b>4.154.159</b>	<b>4.174.175</b>

**7. INVENTARET**

Inventaret përbëhen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	34,551,509	38.591.564
Parapagime per inventar	3,619,048	4.255.128
<b>TOTALI</b>	<b>38,170,557</b>	<b>42.846.692</b>

- 12 -

## Communication Progress Sh.p.k

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat të shprehura në Lek, përveçse kur parashikohet ndryshe)

Zeri "Lende e pare dhe materiale te konsumueshme" perbehet nga inventari kontabel gjendje ne magazine ne daten perkatese.

Zeri "Parapagime per inventar" perbehet nga parapagimet e kryera ndaj furnitoreve, per te cilat malli apo sherbimi pritet te merret ne vitin pasardhes.

#### 8. SHPENZIME TE SHTYRA

Shpenzimet e shtyra përbëhen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Shpenzime te periudhave te ardhshme	206,129	256.563
Pagesa per ankimim per proçedure tenderi	1,013,960	819.920
Shpenzime per praktikante te Bashkise Tirane	43,524	
<b>TOTALI</b>	<b>1,263,613</b>	<b>1.076.503</b>

Zeri "Shpenzime te periudhave te ardhshme" perbehet nga pagesa te kryera deri ne vitin 2019 per shpenzime te periudhave te ardhshme.

Zeri "Pagesa per ankimim per proçedure tenderi" perbehet nga pagesa te kryera per Komisionin e Prokurimit Publik, per proçedura ankimimi te cilat ndodhen ne proçes gjyqesor dhe pritet te perfundojne ne vitet ne vijim.

#### 9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	31/12/2019	31/12/2018
Vlera kontabel neto AAM	25,992,066	29.623.538
Vlera kontabel neto AAJM	121,594	
<b>TOTALI</b>	<b>26,113,660</b>	<b>29.623.538</b>

Ky ze perfaqeson vleren kontabel neto te detajuar sipas pasqyres bashkengjitur te Aktiveve Afatgjata Materiale.

#### 10. ARKËTIME NË AVANCË PËR POROSI

	31/12/2019	31/12/2018
Arkëtime në avancë për porosi	8,217,874	7.000.230
<b>TOTALI</b>	<b>8,217,874</b>	<b>7.000.230</b>

Ky ze perfaqeson vleren gjendje te arketimeve te marra ne avance, ne fund te çdo periudhe, per te cilat realizimi i shitjeve do te behet ne periudhat pasardhese.

#### 11. TË PAGUESHME PËR AKTIVITETIN E SHFRYTËZIMIT

	31/12/2019	31/12/2018
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	36,287,247	21.672.243
<b>TOTALI</b>	<b>36,287,247</b>	<b>21.672.243</b>

Kjo vlerë perfaqeson shumen e papaguar ndaj furnitoreve per materialet e blera me qellim ushtrimin e aktivitetit.

#### 12. TË PAGUESHME NDAJ PUNONJËSVE DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE / SHËNDETËSORE

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore përbëhen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Paga të pagueshme ndaj punonjësve	53,154	7.750
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,343,164	1.380.792
<b>TOTALI</b>	<b>1,396,318</b>	<b>1.388.542</b>

## Communication Progress Sh.p.k

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat të shprehura në Lek, përvecse kur parashikohet ndryshe)

Zeri "Paga të pagueshme ndaj punonjësve" përfaqëson vlerën e pagave të papaguara të periudhës që do të paguhet në periudhën pasardhëse.

Zeri "Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore" përfaqëson vlerën e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të llogaritura për muajin dhjetor të secilës periudhe që do të paguhet në periudhat pasardhëse.

#### 13. TE PAGUESHME PER DETYRIMET TATIMORE

Te pagueshme per detyrimet tatimore përbëhen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP)	875,937	1.146.329
TVSH	5,175,813	9.719.100
Tatim ne burim	161,486	144.131
Tatim fitimi	0	0
Detyrime te tjera doganore	0	13.870
<b>TOTALI</b>	<b>6,213,236</b>	<b>11.023.430</b>

#### 14. TE TJERA TE PAGUESHME/ HUA TE TJERA

	31/12/2019	31/12/2018
Gentian Likaj	13,627,468	1.364.925
Enkeleidi Zoraqi	13,627,468	1.364.926
<b>TOTALI</b>	<b>27,254,936</b>	<b>2.729.851</b>

Zeri "Te tjera te pagueshme/Hua te tjera" i perket vleres se dividendit te deklaruar deri ne vitin 2019 (per te cilin eshte derdhur tatimi ne burim) dhe qe nuk i eshte paguar akoma ortakeve.

#### 15. TE ARDHURA TE SHTYRA

	31/12/2019	31/12/2018
Te ardhura te shtyra- nga shitjet	1,279,379	1.725.261
Te ardhura te shtyra- të tjera	0	400.500
<b>TOTALI</b>	<b>1,279,379</b>	<b>2.125.761</b>

Zeri "Te ardhura te shtyra" perbehet nga paradheniet e arketuara deri ne fund te çdo periudhe per shitjet qe do te realizohen ne periudhat e ardhshme.

#### 16. KAPITALI

Kapitali i shoqërisë përbëhet si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Kapitali i nënshkruar	120.000.000	120.000.000
Fitimi i pashpërndarë	0	19.100.000
Fitimi i vitit ushtrimor	58,444,230	44.514.223
<b>TOTALI</b>	<b>178,444,230</b>	<b>183.614.223</b>

Zeri "Kapitali i nënshkruar" përfaqëson vlerën e kapitalit të shoqërisë.

Zeri "Fitimi i pashpërndarë" përfaqëson vlerën e pashpërndarë të fitimit para vitit ushtrimor.

- 14 -

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat të shprehura në Lek, përveçse kur parashikohet ndryshe)

Zeri "Fitimi i vitit ushtrimor" perfaqeson fitimin e realizuar nga shoqeria gjate vitit 2019.

**17. TE ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT**

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit përbëhen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Deklaruar sipas FDP-ve mujore	351,183,332	294.191.330
Paradhenie me fatura te viteve paraardhese, deklaruar shitje ne vitin ushtrimor	2,552,568	6.774.475
Paradhenie me fatura te vitit ushtrimor, per t'u realizuar ne vitet pasardhese	(3,554,566)	(5.319.616)
Te ardhura te p/ardhshme, nga vitet paraardhese, deklaruar shitje ne v/ushtrimor	1,598,861	2.558.487
Te ardhura te p/ardhshme nga fatura te vitit ushtrimor, per t'u realizuar ne vitet pasardhese	(1,152,979)	(1.725.261)
Autofatura	(1,463,758)	(1.878.993)
Diferenca kursi te paradhenieve	(215,647)	(20.582)
<b>TOTALI</b>	<b>348,947,811</b>	<b>294,579,840</b>

**18. MATERIALE TE KONSUMUESHME**

Materialet e konsumueshme perfaqesojne koston e materialeve te konsumuara per kryerjen e sherbimeve.

	31/12/2019	31/12/2018
Materiale te konsumueshme	175,438,936	129.180.138
<b>TOTALI</b>	<b>175,438,936</b>	<b>129,180,138</b>

**19. SHPENZIME TE PERSONELIT**

Shpenzime te personelit perbehen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Paga dhe shperblime	63,489,781	66.761.476
Shpenzime për kontributet për sigurimet shoqërore/shëndetësore	8,382,893	8.124.051
<b>TOTALI</b>	<b>71,872,674</b>	<b>74.885.527</b>

**20. SHPENZIME KONSUMI DHE AMORTIZIMI**

Shpenzime konsumi dhe amortizimi perbehen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,155,729	5.997.933
<b>TOTALI</b>	<b>6,155,729</b>	<b>5.997.933</b>

Zeri "Shpenzime konsumi dhe amortizimi" perfaqeson amortizimin e llogaritur mbi vleren e mbetur te Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale me normat e amortizimit sipas legjislacionit tatimor ne fuqi.

**21. SHPENZIME TE TJERA SHFRYTEZIMI**

- 15 -

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat të shprehura në Lek, përveçse kur parashikohet ndryshe)

Shpenzime të tjera shfrytëzimi perbehen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Energji Elektrike + Ujë	1,664,864	1.503.438
Sherbim doganor	401,750	480.697
Sigurime të ndryshme	684,189	659.335
Shpenzime postare	21,515	59.247
Shpenzime telefonie	738,804	1.048.010
Mirembajtje dhe riparime të automjeteve	369,693	734.480
Shpenzime karburanti për automjetet	1,699,200	1.618.600
Shpenzime zyre	948,237	1.289.623
Mirembajtje dhe riparime zyre	132,091	128.775
Dieta jashtë & brenda vendit	1,344,915	2.616.446
Shp.profesionale/auditim/vendas, të huaj & kontabel.	2,496,633	1.604.215
Shpenzime noteriale + avokatie	334,500	417.750
Taksa vjetore për automjetet	17,893	12.767
Pritje dhe përfaqësime	1,293,678	1.809.325
Shpenzime sponsorizimi	725,612	384.000
Reklama publicitet promovime	374,178	1.983.817
Shpenzime trajnimi/ partneritete/anetaresime	1,557,045	1.824.760
Abonime të ndryshme	136,622	120.783
Shpenzime transporti/ brendshem	469,339	387.766
Qera zyre/parkimi/gjeneratori	12,454,650	11.610.903
Komisione bankare	786,549	869.446
Taksat vendore dhe të tjera	78,156	69.400
Vlera kontabel e aktiveve të shitura	47,369	372.045
Shpenzime të tjera, kancelare, liçenca dhe marka	424,046	
Shpenzime të pazbritshme	2,795,307	1.057.944
<b>TOTALI</b>	<b>31,996,834</b>	<b>32.663.572</b>

**22. TE ARDHURA TE TJERA**

Te ardhura të tjera perbehen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Te ardhura nga interesat	112,900	326.268
Te ardhura nga diferencat në kurset e kembimit	833,598	632.422
Te tjera financiare	502,185	457.630
Te ardhura të tjera	60,369	
<b>TOTALI</b>	<b>1,509,051</b>	<b>1.416.320</b>

**23. SHPENZIME FINANCIARE**

Shpenzime financiare perbehen si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Shpenzime për interesa	0	0
Shpenzime nga diferencat në kurset e kembimit	1,407,367	2.853.837
<b>TOTALI</b>	<b>1,407,367</b>	<b>2.853.837</b>

**24. SHPENZIME TE TATIMIT MBI FITIMIN**

## Communication Progress Sh.p.k

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat të shprehura në Lek, përveçse kur parashikohet ndryshe)

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin janë llogaritur si me poshte:

	31/12/2019	31/12/2018
Fitimi perpara tatimit	63,585,322	50.415.153
<i>Sistemime per fitimin e tatueshem</i>		
Shpenzime te pazbritshme	2,795,307	3.872.797
Fitimi i tatueshem	66,380,629	54.287.950
<b>Tatim mbi fitimin</b>	<b>5,141,092</b>	<b>5.900.930</b>
Tatim fitimi i paguar gjate vitit (perfshire mbipagesat e mbartura)	(8,664,623)	(9.490.083)
Tatim fitimi i mbipaguar	(3,523,531)	(3.589.153)

Ne zbatim te ligjit 8438, date 28/12/1998 ndryshuar me ligjin nr. 105/2017, dhe VKM 730, date 12/12/2018, fitimi i tatueshem i eshte neshtruar normave te tatimit mbi fitimin si vijon: 5% per aktivitet e zhvillimit te Software-ve dhe 15% per aktivitetet e tjera te fushes se teknologjise se informacionit. Me poshte e datajuar llogaritja per secilen nga normat e tatimit:

Pershkrimi	Total	Aktiviteti i zhvillimit te Software-ve	Aktivite te teknologjise se informacionit
Te ardhura nga shitjet	348,947,810	96,017,728	252,930,082
Te ardhura te tjera financiare	1,509,052	0	1,509,051
<b>Total te ardhura</b>	<b>350,456,862</b>	<b>96,017,728</b>	<b>254,439,133</b>
<b>Raporti sipas aktiviteve (ne %)</b>	<b>100%</b>	<b>27.4%</b>	<b>72.6%</b>
Shpenzime direkte	(227,607,494)	(32,386,472)	(195,221,022)
Shpenzime indirekte (sipas %)	(59,264,046)	(16,237,088)	(43,026,958)
<b>Total Shpenzime</b>	<b>(286,871,540)</b>	<b>(48,623,560)</b>	<b>(238,247,980)</b>
Fitimi para tatimit	63,585,322	47,394,168	16,191,153
Shpenzime te pazbritshme	2,795,307	765,855	2,029,452
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>66,380,629</b>	<b>46,628,313</b>	<b>14,161,701</b>
Tatim mbi fitimin 15%	2,733,091	0	2,733,091
Tatim mbi fitimin 5%	2,408,001	2,408,001	0
<b>Total tatim mbi fitimin</b>	<b>5,141,092</b>	<b>2,408,001</b>	<b>2,733,091</b>

#### 25. FITIMI/HUMBJA E VITIT

Fitimi neto i vitit financiar eshte llogaritur si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi perpara tatimit	63,585,322	50.415.153
Tatim fitimi	5,141,092	5.900.930
<b>Fitimi pas tatimit</b>	<b>58,444,230</b>	<b>44.514.223</b>

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë miratuar nga menaxhimi dhe firmosur më 25 mars 2020 nga:

Administrator  
Gentian Likaj



Përgatitur nga:  
Financa Jote Sh.p.k

